

Syllabus i lëndës

Lënda: Tefsir II (*METODOLOGJIA E KOMENTIMIT TË KURANIT*)

Programi i studimit: Teologji Islame

Numri i ECTS kredive: 7 ECTS Kredi

Niveli dhe lloji i lëndës: Obligative

Kodi i lëndës: 203

Fondi i orëve: 3+2

Semestri: 2024/2025

Mësimdhënsi: Dr. Valmire Batatina Krasniqi

Kontakti: valmire.batatina@fsi-edu.net

Përmbajtja e shkurtër e lëndës:

Lënda “Metodologjia e interpretimit të Kuranit” është një disiplinë akademike dhe teologjike që studion mënyrat dhe metodat e duhura për të interpretuar tekstet e Kuranit. Kjo lëndë përfshin disa aspekte kryesore: Studimi i parimeve dhe rregullave që duhet të ndiqen gjatë interpretimit të Kuranit. Njohjen me historinë e shkencës së tefsirit, zhvillimin e saj në periudha të ndryshme, dhe kontributet e dijetarëve të ndryshëm në këtë fushë. Studimi i llojeve të ndryshme të tefsirit, përfshirë tefsirin literal (bazuar në kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalëve), tefsirin kontekstual (duke marrë parasysh kontekstin historik dhe kulturor), tefsirin analogjik, dhe tefsirin ezoterik ose mistik. Kjo përfshin përdorimin e burimeve të ndryshme për interpretimin e Kuranit, siç janë vetë Kurani, hadithet (fjalët dhe veprat e Muhamedit a.s), mendimet e sahabeve (shokët e Muhamedit a.s), dhe mendimet e dijetarëve të njohur të islamit. Interpretimi i Kuranit në kontekstin e çështjeve bashkëkohore dhe si të përballohen sfidat e reja që lidhen me zhvillimet shoqërore, shkencore dhe teknologjike.

Qëllimi i lëndës

-Të i njoftoj studentët në literaturën e larmishme tefsirore, (të komentareve dhe të komentuesve të Kuranit), t'ua paraqes rrjedhat kryesore të mendimit tefsiror- komentues, duke filluar që nga shekulli i parë sipas kalendarit lunar, gjegjësisht të shekullit të VII-të gregorian.

-Të përshkruaj metodologjitë e duhura për të interpretuar Kuranin në mënyrë të saktë dhe të qëndrueshme, duke respektuar parimet e vendosura nga dijetarët e hershëm të islamit dhe duke qenë të hapur ndaj sfidave të kohës moderne.

- Lënda mësimore në fjalë, poashtu sjell njohuri edhe mbi jetëshkrimet e mufesirëve (komentuarëve) të famshëm përgjatë historisë islame, si dhe mbi frymën dhe rrethanat e kohës në të cilën ata kanë jetuar, duke vazhduar deri tek ata më bashkëkohorët në këtë fushë.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje:

-Të njoh kuptimin e thellë dhe të nuancuar të ajeteve të Kuranit, duke njohur kontekstin historik, gjuhësor dhe kulturor të tyre.

-Të zhvilloj aftësi të avancuara në analizimin dhe interpretimin e teksteve, duke përdorur metoda të ndryshme të tefsirit dhe burime të ndryshme interpretimi.

- Të përshkruaj evolucionin historik të shkencës së tefsirit dhe kontributit të dijetarëve të ndryshëm në këtë fushë.

-Të përshkruaj dallimet mes komentareve (autorëve) dhe komentimeve të tyre.

-Të përshkruaj frymën komentuese të tyre, me animet sektare dhe ideologjike, me ndikimin e shkollave juridike islame.

- Të njoh parimet dhe rregullat e interpretimit në mënyrë të qëndrueshme dhe të saktë.

-Të shqyrtoj metodat e interpretimit të Kuranit si tradicionale, racionale, filozofike, mistike dhe letrare, por edhe ideologjike dhe politike.

- Zhvillimi i aftësive për të interpretuar Kuranin në kontekstin e çështjeve dhe sfidave bashkëkohore, duke marrë parasysh zhvillimet shoqërore, shkencore dhe teknologjike.

- Zhvillimi i mendimit kritik dhe aftësisë për të analizuar dhe vlerësuar interpretimet e ndryshme, duke i krahasuar ato me parimet themelore të Islamit.

-Të zhvilloj aftësi kërkimore të avancuara, duke qenë në gjendje të kryej hulumtime të thelluara dhe të dokumentuara mbi temat e ndryshme të tefsirit.

-Rritja e ndërgjegjësimit etik dhe fetar, duke pasur parasysh përgjegjësinë që mbart interpretimi i Kuranit dhe ndikimi i tij në jetën e besimtarëve.

Metodologjia e mësimdhënies:

Metodologjia e mësimdhënies së lëndës “Metodologjia e interpretimit të Kuranit” përfshin një qasje të strukturuar dhe të shumëanshme për të siguruar që studentët të përvetësojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të interpretuar në mënyrë korrekte dhe të thelluar Kuranin. Realizimi dhe artikulumimi i ligjeratave do të përcjellat me shumëllojshmëri të metodave si: Leksionet Teorike-shpjegimi i parimeve bazë të interpretimit të Kuranit, duke përfshirë historikun, zhvillimin dhe llojet e ndryshme të tefsirit. Duke përdorur tekste të njohura dhe burime të besueshme, leksionet sigurojnë një kuptim të thelluar të teorisë së interpretimit. Diskutimet në klasë- paraqesin dimension të rëndësishëm në këtë lëndë- inkurajimi i studentëve të diskutojnë dhe të debatojnë rreth temave të ndryshme për të zhvilluar mendimin kritik dhe aftësinë për të argumentuar në mënyrë të informuar. Studentët ndajnë dhe krahasojnë interpretimet dhe këndvështrimet e tyre, duke pasuruar njëri-tjetrin me mendime dhe qasje të ndryshme.

Hulumtime dhe projekte- Studentët kryejnë hulumtime mbi tema të caktuara të tefsirit dhe prezantojnë gjetjet e tyre. Duke përfshirë kërkimin bibliografik dhe analizën kritike të burimeve të ndryshme. Lexime të Drejtuara dhe Studime të Rasteve: Lexime nga veprat e dijetarëve të njohur të tefsirit dhe studimi i rasteve specifike të interpretimit të ajeteve për të kuptuar aplikimin praktikë të metodologjive të ndryshme. Vizita dhe Leksione nga Ekspertë të Fushës: Ftesa e ekspertëve të fushës për të dhënë leksione dhe për të ndarë përvojat e tyre praktike.

Kjo metodologji mësimdhënjes siguron një qasje të gjithanshme, duke kombinuar teorinë me praktikën dhe duke nxitur mendimin kritik dhe aftësitë kërkimore tek studentët.

Përmbajtja e lëndës:

Java e parë: Hyrje në lëndën mbi metodologjinë dhe historikun e komentimit të Kur`anit. Njoftim me plan programin e lëndës- syllabusin si dhe me formën e zhvillimit të ligjeratave dhe vlerësimit të studentëve.

Literatura: Ahmed Adiloviç: “**Kolosët e shkencave të Tefsirit**” Prishtinë, 2010. Muahmed Hysejn Edh-Dhehebij “**Et-tefsir vel Mufesirun**” Kairo, 1997.

Java e dytë: *PËRKUFIZIMI I TEFSIRIT*- Ekzegjesës kur`anore, nevoja për tefsir, rëndësia e posaçme e tefsirit.

Literatura: Ahmed Adiloviç “**Kolosët e shkencave të Tefsirit**” f. 1-6

Java e tretë: *KRIJIMI DHE ZHVILLIMI I TEFSIRIT* - Në kohën e të dërguarit, në kohën e shokëve të tij të ngushtë-sahabëve dhe në kohën e gjeneratës së dytë-tabi-inëve

Literatura: Ahmed Adiloviç “**Kolosët e shkencave të Tefsirit**”f. 6-12

Java e katërt: *PERIUDHA E HARTIMIT TË LËNDËS SË TEFSIRIT*- fillimi i shkrimit të veprave të veçanta të tefsirit, periudha e anashkalimit të transmetimit verbal zingjiror-sendeti,

periudha e anësisë medh-hebore dhe fraksioneve, periudha e rilindjes dhe mëkëmbjes, kushtet të cilat duhet t'i plotësojë mufesiri-komentari i Kur'anit.

Literatura: Ahmed Adiloviç “Kolosët e shkencave të Tefsirit”f. 12-16

Java e pestë: *LLOJET E TEFSIRIT*- Tefsiri tradicional, tefsiri racional, tefsiri gjuhësor, tefsiri i fikut-legjislativ-sheriatik, tefsiri sufist –misitik ose aluziv, tefsiri dogmatik, tefsiri shkencor, tefsiri reformist, mënyra tjera të interpretimit, mënyra më e preferuar e komentimit të Kur'anit.

Literatura: Ahmed Adiloviç “Kolosët e shkencave të Tefsirit”f. 16-23

Java e gjashtë: *TEFSIRI TRADICIONAL*- Ibni Abbasi, aftësia e veçantë e kujtesës, arsyet e diturisë së tij të veçantë, Ibni Abbasi si komentatorë, tefsiri i Ibni Abbasit, trillimi dhe atribuomi i fjalëve që nuk janë të tijat, angazhimi i Ibni Abbasit në shoqëri.

Literatura: Ahmed Adiloviç “Kolosët e shkencave të Tefsirit”f. 23-36.

Java e shtatë: *MUXHAHID IBN XHEBER* - Jeta dhe vepra e tij, kontributi i tij në tefsir. *IBNI XHERI ET-TABERI*- jeta e tij, rrethanat kohore në të cilat ka jetuar, veprat e tij, tefsiri i tij, metodologjia e komentimit të Kur'anit nga Ibni Xherir Et-taberij, tekste ilustruese të komentarit të tij. (Mumtehine 1-8).

Literatura: Ahmed Adiloviç “Kolosët e shkencave të Tefsirit”f.36-54.

Java e tetë: *HYSEJN IBNI MESUUD EL-BEGAVI*- biografia dhe bibliografia e tij, vepra e tij mbi tefsirin dhe metodologjia e komentimit të Kuranit. *IBNI ATIJE EL-ENDELUSI*- biografia dhe bibliografia e tij, rrethanat historike dhe politike në kohën e veprimtarisë së tij, tefsiri i Endulusiut dhe fryma komentuese e tij.

Literatura: Ahmed Adiloviç “Kolosët e shkencave të Tefsirit”f. 54 -70.

Java e nëntë: *IBNI KETHIRI*- biografia dhe bibliografia e tij, rrethanat kohore në të cilat ka vepruar, natyra e tefsirit të tij, metodologjia tradicionale e tij në komentimin e Kuranit. *ABDURRAHMAN BIN MUHAMMED ETH-THEALEBIJ* dhe roli i tij në komentimin e Kuranit në veçanti në vijën tradicionale të komentimit të Kuranit, karakteristika e veprat së tij në tefsir.

Literatura: Ahmed Adiloviç “Kolosët e shkencave të Tefsirit” f. 70-92.

Java e dhjetë: *XHELALUDIN ES-SUJUTI*- e veçanta e Tefsirit të tij. Xhelaludini si enciklopedist i shumë fushave shkencore islame. *MUHAMMED BIN ALIJ ESH-SHEVKANI*- tefsiri i tij në frymën e vijës interpretuese tradicionale të komentimit të Kuranit.

Literatura: Ahmed Adiloviç “Kolosët e shkencave të Tefsirit” f. 92-128.

Java e njëmbëdhjetë: *ZANAFILLA E TEFSIRIT RACIONAL, TEFSIRI GJUHËSOR DHE STILISTIK*- Muhamed bin Omer Ez-Zemahsheri, vlerat e e tefsirit të Ez-Zamahsheriut. Ebu Hajan El-Endelusi, tefsiri dhe karakterstikat e tij, tekste ilustruese të komentarit të tij. (Bekare 1-8).

Literatura: Ahmed Adiloviç “Kolosët e shkencave të Tefsirit” f. 128-152.

Java e dymbëdhjetë: *TEFSIRI ANALITIK*-Nasirudin El-Bejdavi, metodologjia e komentimit të El-Bejdaviut në komentuarin e tij “Envaru tenzil ve Esrarut- t`eviil”, tekste ilustruese të komentarit të tij. (Araf 172-174).

Literatura: Ahmed Adiloviç “Kolosët e shkencave të Tefsirit”f. 152-169.

Java e trembëdhjetë: *ZANAFILLA E KOMENTIMIT BASHKËKOHOR TË KOMENTIMIT TË KUR`ANIT*. Protagonistët e komentimit bashkëkohor të Kur`anit. Rrethanat politike dhe historike si motiv i lindjes së komentimit bashkëkohor të Kuranit.

Literatura: Ahmed Adiloviç “ Kolosët e shkencave të Tefsirit”f. 233.

Java e katërbëdhjetë: *SHKOLLAT BASHKËKOHORE RACIONALISTE DHE REFORMISTE NË TEFSIR*. Xhemaludin Afagani , Muhamed Abdu, Reshid Rida, Hasan El-Benna, Sejjid Kutub. Vizita dhe Leksione nga Ekspertë të Fushës.

Literatura: Ahmed Adiloviç “ Kolosët e shkencave të Tefsirit”f. 240.

Testi, studentët do të ndahen në dy grupe për mbajtjen e testit përfundimtar.

Kriteriumi dhe komponentët e vlerësimit:

Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjëratë 10%

Punimi seminarik 20%

Testi intermedier 30%

Provimi final 40%

Total 100%

Standardi i notimit në FSI:

10= 90 - 100. SHKËLQYESHËM- njohuri të shkëlq. me vetëm disa gabime minore.

9= 81 – 89. SHUMË MIRË – mbi mesatare standarde, por me disa gabime.

8=71 – 80. MIRË – rezultat në përgjithësi i mire me disa gabime që vërehen.

7=61 – 70. KËNAQSHËM – mire,por me mjaft gabime.

6=51 – 60. MJAFTON – rezultatet plotësojnë kriteret minimale.

5=0 – 50. DOBËT – kërkohet shumë punë për të fituar kredi.

Literatura themelore-obliguese:

1. Ahmed Adiloviç “ Kolosët e Tefsirit “ Prishtinë, 2009, përkthyer nga gjuha boshnjake, Xhabir Hamiti.
2. Muhamed Hysejn Edh-Dhehebi “ Et-tefsir ve'l-Mufesirun” Kairo, 1997.

Literatura opcionale-plotësuese:

3. Zerekshiu, “ El-Burhan fi Ulumil Kur`an” , Kairo, 1957.
4. Subhi Salih “ Mebahith fi ulumil Kuran “ Bejrut, 1968.
5. Arthur Jefery, “ Materials, for the history of the text of the Quran”, Leiden, 1937.
6. Bintu Shati “ Et-fesirulbejjan lil Kuranil Kerim”, Kairo , 1968.
7. Muhamed Ali Sabunij, “ Etibjan fi ulumil Kuran” , Mekke, 1389h.
8. Ali hasan El-Arid, “ Tarihi ilmu tefsir ve menahixhul mufesiriine” Kairo, 1980.
9. Muhsin Demirci, Tefsir Tarihi, Istanbul, 2010.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studenti është i obliguar për vijimin e rregullt të ligjëratave dhe ushtrimeve (mbahet evidenca për studentët e rregullt). Të gjithë studentët janë të obliguar t'i përfillin rregullat e mirësjelljes: mbajtja e qetësisë gjatë mësimit si dhe respektimi i kohës së ligjeratës. Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike duhet të fikën (apo të lihen në vibrim/pa zë) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.

Shënim: Nëse vijueshmëria e një studenti në ligjeratë vlerësohet nën 70%, atëher ai/ajo do ta humb të drejtën që t'i nënshtrohet kolokviumit dhe provimit final për 40 pikë.

Konsultimet:

Orët e konsultimeve mbahen në kabinet sipas orarit të dhënë dhe mund të shfrytëzohet për ndihmë për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me lëndën.